
	<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova - Republic of Kosovo</b>  <b>Komuna e Prishtinës</b> <b>Opština Priština -Municipality of Prishtina</b>	
---	--	---

Datë/a:	04.04.2018
Referenca	Kërkesa për rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit Numër 616 17 3336 423-Konkurs projektimi për hartimin e projektit me nevojë të veçanta Sindrom Down dhe Autizem
Për/ Za/ To:	Departamentin e Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj, Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subjek	Njoftim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

Zyrtari përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në nenin 108/A pika 10 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LPP nr.04/L-042 (numër Nr.05/L-068) dhe nenit 7 dhe 8 të Rregullave për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP-se vlerën e tarifave të ankesave, merr:

### VENDIM

- Për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga OE-ik "PREMIUM ENGINEERING"

### Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prishtinës – Zyra e Prokurimit në bazë të kërkesës për rishqyrtim të datës 03.04.2018 bëri një analizë të hollësishme të kërkesës dhe konstatoj se pretendimet tuaja në të gjitha pikat e paraqitura nga ana juaj janë të paqëndrueshme:

1. Vlerësimin e ofertave e bëri juri profesionale nga aspekti i përgatitjes profesionale dhe nga ana ligjore nuk kemi të drejtë të konstatojmë vlerësimin profesional të jurisë. Për shkak të karakterit specifik që ka ky projekt Autoriteti Kontraktues ka caktuar juri profesionale të jashtme dhe do të ishte e pakuptimtë që një komision me përgatitje më të ulët të bënte një rivlerësim të tillë dhe
2. Në mes të Komunës së Prishtinës – për instalimin e qendrës së autizmit dhe sindromes Down në Prishtinë dhe zyrës së kryeministrit – agjencia turke për bashkëpunim dhe koordinim kanë bërë një memorandum të bashkëpunimit me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit reciprok në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, në frymën e miqësisë ndërmjet dy shteteve.

Në nenin 3 të këtij memorandumimi – Obligimet e TIKA-as. pika a) janë:

Te sigurojë projektin për instalimin e Qendrës së Autizmit dhe Sindromës Down dhe të dërgoj për shqyrtim dhe aprovim në Komunën e Prishtinës.

Bazuar në këtë konstatim se Njoftimi për eliminim dhe anulim të aktivitetit të prokurimit është i bazuar dhe se propozimet e komisionit të vlerësimit janë në harmoni me Ligjin dhe me kërkesat e dosjes së tenderit

Ky vendim është i obligueshëm për Autoritetin Kontraktues, ndërsa parashtruesi i kërkesës nëse mbetet i pakënaqur mund të dërgoj ankesë në OSHP në afatin brenda dhjetë ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës dhe
- Departamentit të prokurimit.